

RAPORT TEKNIK

Objekti:

**"RIKONSTRUKSION I RRJETIT TE NDRICIMIT RRUGOR
DHE SINJALISTIKES NE QYTETIN E RROGOZHINES"**

BASHKIA RROGOZHINE



Autor i Projektit
"ARABEL-STUDIO" shpk

VITI - 2018

PERMBAJTJA E RAPORTIT TEKNIK

1. TE PERGJITHSHME

1.01 Hyrje

1.02 Vend Ndodhja e objektit

1.03 Gjendja Egzistuese

2. ZGJIDHJA E PROJEKTIT

2.01 Projekti i Rruges

2.02 Detaje

3. PREVENTIVI I PUNIMEVE

3.01 Preventivi me Çmime

3.02 Preventivi pa Çmime

3.03 Volumet e Punimeve

4. SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. TE PERGJITHSHME

1.01 Hyrje

"RIKONSTRUKSION I RRJETIT TE NDRICIMIT RRUGOR DHE SINJALISTIKES NE QYTETIN E RROGOZHINES"

ndodhen në hyrje te Rrogozhines, Bashkia Rrogozhine. Rruget hyrese ne qytetin e rrogozhines jane ne gjendje tejet te amortizuar dhe rrjeti I ndricimit te demtuar dhe jo funksional.

Objekti **"RIKONSTRUKSION I RRJETIT TE NDRICIMIT RRUGOR DHE SINJALISTIKES NE QYTETIN E RROGOZHINES"** eshte planifikuar të realizohet me fonde të bashkise Rrogozhine.

Objekti i këtij projekti është vendosja e shtyllave te ndricimit pergjate rruges ne segmente te caktuara.

1.02 Vend Ndodhja e Objektivit

Objekti **"RIKONSTRUKSION I RRJETIT TE NDRICIMIT RRUGOR DHE SINJALISTIKES NE QYTETIN E RROGOZHINES"**

ndodhen në hyrje te Rrogozhines, Bashkia Rrogozhine

Horografia e rrjetit te ndricimit te zones





1.03 Gjendja Aktuale e Objektivit

Segmentet rrugore hyrese ne qytetin e Rrogozhines, aktualisht eshte ne gjendje te amortizuar. Do te behet nderhyrje kryesisht ne ndricimin e rrugeve, dhe sistemimi i tyre.

2. ZGJIDHJA E PROJEKTIT

Projekti i Rruges

Objekti "RIKONSTRUKSION I RRJETIT TE NDRICIMIT RRUGOR DHE SINJALISTIKES NE QYTETIN E RROGOZHINES"

jane projektuar ne perputhje me kerkesat e percaktuara nga Bashkia Rrogozhine.

Projekti i Ndricimit Rrugor

Rrjeti i ndricimit rrugor do te perbehet nga shtyllat elektrike ne njerin krah ne segmentin e pre dhe ne segmentin e trete ne dy krahet e rruges me lartesi 7m

+ ndricuesat LED, dhe rrjeti kabllor. Gjithashtu ne te tere rruget e bllokut do te ndertohet sistemi i ndricimit rrugor.

Ndricimi rrugor do te jete ai ekzistues por duke bere te mundur riparimin e shtyllave te ndricimit te demtuara dhe nderrimi i te gjithe ndricuesve ekz me ato te rinj LED . Lartesia e shtyllave dhe fuqia e ndricuesve varion ne funksion te gjeresise se rruges. Shtyllat do jene me lartesi 8.8 m.

Mbi shtylla tipi I pare do vendosen ndricuesit me llampa ndricimi me fuqi 150 W LED,ndersa tipi I dyte I shtyllave qe vazhdon ne qendren e qytetit do jene me dy ndricues ne nivele te ndryshme ,ndricuesit per kembesoret me fuqi 50w dhe ndricuesit me lart 100w.

Ndricuesit do jenë me gradë të lartë rezistence dhe me reflektor alumini me luçidim të lartë i paoksidueshëm.


Linjat e ndricimit do të jetë me trase nëntokësore me tub plastik fleksibël me dy shtresa $\varnothing=63$ mm për kalimin e kabllit të furnizimit me energji elektrike dhe tub celiku $\varnothing=110$ mm për intersektimin e trupit te rruges. Pusetat të jenë prej betoni me përmasa brënda përbrënda 30x30x30cm me kapak gize. Pusetat do te vendosen mbrapa çdo shtylle. Panelet e komandimit të vendosen të rinj me komandim me fotoelementë.

Energjia i rrjetit të ndricimit do të merret ne kabinat egzistuse te zones. (Keto pika lidhjeje mund te ndryshohen nese nuk do aprovohen nga OSHE).


Në cdo kabine do të instalohen panelet e ndricimit rrugor te cilet do ushqehen me ure të veçante nga transformatori. Në cdo kabinë eshte parashikuar dhe vendosja e matësve të energjisë.

Tipi 1

NDRICUES TIP 1



Tipi 2



PROJETKT PROPOZIM

Vendosja e sinjalistikës rrugore në Bashkinë e Rrogozhinës

PËRMBLEDHJE

- 1. HYRJE**
- 2. LEGJISTLACIONI REFERUES**
- 3. NOCIONE MBI SINJALISTIKEN RRUGORE**
- 4. SHEMBUJT TË VENDOSJES TE SINJALISTIKËS NË BASHKINË
RROGOZHINË**
- 5. PREVENTIV EKONOMIK**

1. HYRJE

Siguria rrugore është një temë shumë e rëndësishme e cila duhet trajtuar me përpikmëri.

Siguria rrugore në ditët e sotme nuk ka një nivel të lartë dhe kjo identifikohet më së miri nga aksidentet e shumta që fatkëqsisht po shtohen dita ditës.

Zhvilimet bashkëkohore në rrjetin urban dhe interurban si dhe fenomenete dukshme që janë konstatuar, e bëjnë të domosdoshëm realizimin e sinjalistikës rrugore në tërë gamën e saj.

Mungesa apo amortizimi i sinjalistikës rrugore është një nga shkaktarët kryesorë të aksidenteve në rrugët tona të cilat, me ndarjen e re territoriale kanë fituar një intensitet të ri frekuentimi.

Konkretisht, në Bashkinë Rrogozhinë, rrjeti rrugor dhe urbanizimi i gjithmonë e më shumë në zhvillim kërkon ndërhyrje konkrete për vendosjen, plotësimin apo zëvendësimin korrekt të sinjalistikës rrugore.

2. LEGJISLACIONI PËR SINJALISTIKEN RRUGORE

Sinjalet rrugore dhe përdorimi i tyre në Shqipëri rregullohen nga:

Neni 39 i Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 8378, dt. 22/07/1998, Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë;

Vendimi nr. 153, dt 07/04/2000 të Këshillit të Ministrave, “Rregullore për zbatimin e kodit rrugor”

Konventa “Mbi shenjat dhe sinjalet e rrugës”

3. NOCIONE BAZË

Sipas karakteristikave të tyre konstruktive, teknike dhe funksionale rrugët klasifikohen si vijon:

- Autostradë
- Rrugë interurbane kryesore
- Rrugë interurbane dytesore
- Rrugë urbane kryesore
- Rrugë urbane dytesor
- Rrugë lokale

Duke u nisur nga fakti se subjekti kryesor i këtij propozimi janë rrugët urbane dhe lokale në territorin e Bashkisë Rrogozhinë, në vijim do të thellohem disi në shpjegimin e disa nocioneve dhe dispozitave përkatëse:

RRUGË URBANE KRYESORE: Rrugë me karrexhata të pavarura, ose te ndara nga trafikndarës, secila me të paktën dy korsi levizjeje dhe një korsi e

mundshme e rezervuar për mjete publike, bankina të shtruara dhe trotuare, me kryqezime në nivel të pajisura me semafor, për qëndrimin janë parashikuar zona ose breza anesore jashtë karrexhates, të dyja me hyrje dhe dalje të përqëndruara.

- *RRUGË URBANE DYTËSORE*: Rrugë me një karrexhatë me të pakten dy korsi, bankina të shtruara dhe trotuare. Për qëndrimin janë parashikuar zona të pajisura me korsi manovrimi jashtë karrexhatës.
- *RRUGË LOKALE*: Rrugë urbane ose interurbane, e sistemuar në menyrë të përshtatshme sipas përkufizimeve, por që nuk bën pjesë në rrugët e mësipërme.
- *QARKULLIMI*: Quket lëvizja, ndalimi dhe qëndrimi i këmbësorëve, mjeteve dhe kafshëve në rrugë.
- *QENDËR E BANUAR*: Bashkësi ndërtesash, e kufizuar përgjatë rrugëve në hyrje dhe në dalje me sinjale të posacme të fillimit dhe fundit; me bashkësi ndërtesash kuptojmë një grupim të vazhdueshëm dhe të ndërprerë nga rrugë, sheshe, lulishte e zona të përdorimit publik me hyrje për mjetet dhe këmbësoret në rrugë.
- *SINJALISTIKA RRUGORE*:

Shenjat e rrezikut në rrugë jashtë qendrave të banuara vendosen në largësi prej 150-250 meter para rrezikut të shënuar me shenjë kurse në qendrat e banuara vendosen në largësi edhe më të vogël se 150 metër.

Shenjat e urdhërave të prera kanë formë rrethore dhe vendosen në atë vend ku hyjnë në funksion. Shenjat e urdhërave të prera kanë këto domethënie ndalim, kufizim dhe detyrim. Shenjat e detyrimit kanë formë rrethore ngjyra themelore e tyre është e kaltërt dhe simbolet e bardha.

Shenjat e Lajmërimit lajmërojnë pjesëmarrësit në komunikacion për informatat e rrugës nëpër të cilën lëvizin, i lajmërojnë për emërimet e vendeve, largësitë, mbarimin e shenjave të urdhërave të prera për objektet hoteliere dhe për vendet në të cilat pjesëmarrësit në komunikacion mund të kryejn shërbime të ndryshme. Shenjat e lajmërimit kanë formë drejtkëndëshi. Ngjyra themelore e shenjave të lajmërimit është e kaltërt përkatësisht dhe e bardhë.


- *SINJALET HORIZONTALE* të cilat ndahen në:
 - ✓ Vija gjatësore;
 - ✓ Vija tërthore;

- ✓ Vendkalime këmbësorësh ose biçikletash;
 - ✓ Shigjeta drejtuese;
 - ✓ Shkrime dhe simbole;
 - ✓ Vija kufizuese për vendet e qëndrimit ose për vendqëndrimet rezervuara;
 - ✓ Ishuj trafiku ose sinjalizimi paraprak për pengesa brenda karrexhatës;
 - ✓ Vija kufizuese të stacioneve të qëndrimit të mjeteve të transportit publik të linjës;
 - ✓ Sinjale të tjera të parashikuara nga aktet në zbatim.
-
- *SINJALET VERTIKALE* të cilat ndahen në:
 - ✓ Sinjale të rrezikut
 - ✓ Sinjale urdhëruese, të cilat ndahen në:
 - Sinjale përparësie
 - Sinjale ndalimi
 - Sinjale detyrimi
 - ✓ Sinjale treguese, të cilat ndahen në:
 - Sinjale paralajmëruese
 - Sinjale të drejtimit
 - Sinjale pohuese
 - Sinjale të identifikimit të rrugëve
 - Sinjale të itinerarit
 - Sinjale të qendrave urbane
 - Sinjale të emrave të rrugëve
 - Sinjale turistike të territorit
 - Sinjale të tjera që japin informacion të dobishëm për drejtimin e mjeteve
 - Sinjale të tjera që tregojnë impiante dhe shërbime


4. SHEMBUJ TË VENDOSJES TË SINJALISTIKËS NË BASHKINË RROGOZHINË

	<div style="display: flex; flex-direction: column; align-items: center;">  <p style="text-align: center;">Tabele treguese flamur ne hyrje te qytetit, Paralajmerim kthese, ndalim qarkullimi i mjeteve te renda</p> </div>
	<div style="display: flex; flex-direction: column; align-items: center;">  <p style="text-align: center;">Ndalim Pushimi, Kufizim shpejtesie ne te dyja drejtimet e levizjes, Nderhyrje nga ana e majte dhe e djathte me precedence ne rrugen kryesore</p> </div>

"RIKONSTRUKSION I RRJETIT TE NDRICIMIT RRUGOR DHE SINJALISTIKES NE QYTETIN E RROGOZHINES"



Polic i shtrire, Vizime pedonale, Tabele pedonale me ndricim, Tabele paralajmeruese poilc i shtrire



Kufizim shpejtesie, Ndalim pushimi nga nje ane, Ndalim borie, Ndalim qarkullim karroce

	
	
	<p>Taxi, Ndalim pushimi me perjashtim te invalideve, paralajmerim horizontal dhe vertikal shkolle</p>

"RIKONSTRUKSION I RRJETIT TE NDRIÇIMIT RRUGOR DHE SINJALISTIKES NE QYTETIN E RROGOZHINES"

	 <p>Kufizim shpejtesie, ndalim pushimi, ndalim borie,</p>
	 <p>Kufizim shpejtesie, Ndalim parakalimi, Ndalim inversioni, Tabele detyruese</p>



5.PREVENTIVI I PUNIMEVE

Preventivi i punimeve te ndertimit eshte ne vleren **24,281,426** leke, perfshire TVSH, ku Çmimet janë sipas VKM NR. 629 dt. 15.07.2015.

6.VOLUMET E PUNIMEVE

Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	238
Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	m3	238
Mbushje me zhavorr (mbi tuba)	m3	190
F.Montim shtylle konike 8ml , LED me nje krahe cdo 30ml perfshire te gjithe aksesoret e nevojshem.	cope	33
F.Montim shtylle konike 8ml , LED me dy krahe cdo 30ml perfshire te gjithe aksesoret e nevojshem.	cope	58
F.V. kuader komandimi me fotoelement	cope	1
F.V. Kabell FG7OR 0.6/ 1KV, 5x10mm ²	ml	700
F.V. Kabell FG7OR 0.6/ 1KV, 5x6mm ²	ml	674
F.V. Kabell FG7OR 0.6/ 1KV, 5x4mm ²	ml	792
Shirit Sinjalizues	ml	2166
F.V. tub fleksibel me 2 shtresa D=80mm per elektrik	ml	792
F.V . Tub metalik D = 200 mm	ml	21
F V pusete elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm	cope	6

Tabel Flamur 2x1m	Cope	1
Tabela kufizim shpejtesie	Cope	46
Tabela detyruese	Cope	28
Tabela paralajmeruese	Cope	18
Tabela ndaluese	Cope	16
Tabela TAXI bashke me shtyllen mbajtese	Cope	3
Tabela Stacion Autobusi bashke me shtyllen mbajtese	Cope	3
Tabele treguese per mjetet e transportit publik bashke me shtyllen mbajtese	Cope	3
Tabela orjentuese	Cope	12
Tabela sherbimeve publike bashke me shtyllen mbajtese	Cope	9
Polic i shtrire prej gome	m.l.	32
Sinjalstike horizontale (vijeze ndarese, vijeze ne nyjet hyrese dhe dalese, vijezet e qendres, vijezet e institucioneve publike, vijezet e parkimit, vijezet e stacioneve dhe kategorive prioritare, vijezet e kembesoreve, etj)	m ²	2650

Shenim:

- Te gjitha vlerat e mesiperme perfishjne furnizim dhe vendosje;
- Te gjitha punimet ne perputhje me standartet europiane te sigurise rrugore;

Per:

"ARABEL-STUDIO" sh.p.k.

Ing. Ardi Arkaxhiu